

VITI XVI, NUMRI 12 / DHJETOR 2012

FOREVER



HUNGARY | ALBANIA | BOSNIA AND HERZEGOVINA | CROATIA | MONTENEGRO | SERBIA | SLOVENIA



HAWAII
GLOBAL RALLY
2013
21-29 APRIL



Duke shikuar përpara



Duket se më ndodh çdo Dhjetor, kur afron Viti i Ri, që më nxit të reflektoj për sukseset dhe sfidat e vitit që shkoi, dhe duke hedhur sytë pas tek 2012, them se ai për Foreverin ka qenë një vit prrallor. Që nga Super Rally i fundit i zhvilluar pikërisht këtu në Phoenix deri te shpallja e programit të ri stimulues Chairman' Bonus, tek futja i programit të ri interesant Eagle Manager' Retreat në Sardenjë të Italisë, viti 2012 sigurisht është një nga vitet për tu mbajtur mend! Ndërkohë që reflektimi sigurisht është një praktikë që ia vlen, sekreti më i madh për sukses është të mësohesh të shikosh përpara. Sikurse është shprehur dikur Benjamin Franklin: „Duke mos u përgatitur, ti je përgatitur për dështim”. Prandaj Dhjetori është muaji perfekt për të bërë planin tuaj për vitin e ardhshëm. Këtu janë katër hapa të thjeshtë që në interes të kësaj do dëshiroja tua sugjeroja për ti bërë:

Përqëndrohu në gjërat vërtet të rëndësishme!

Është gjë e lehtë të mësohemi të bëjmë një listë të të gjithë gjërave që do të bëjmë gjatë ditës, të derdhim plehërat, të prenotojmë biletën për pushime, apo të lemë takim me 5 vetë të rinj për distributorë të mundshëm. Por në fakt shumë nga detyrat që i vemë vetes nuk kontribuojnë shumë për ndonjërin nga qëllimet që i kemi vënë vetes në jetë dhe sigurisht as qëllimit për një biznes të sukseshëm në Forever. Hidhni një sy listës të gjërave që keni për të bërë dhe caktoni: prioritare, prioritare, prioritare. Përcaktoni çfarë mund të lini mënjane për të gjetur më shumë kohë për ato që ia vlejné. Kini parasysh, që gjërat që ia vlejné më shumë të mos i harrojmë për gjëra që ia vlejné më pak!

Kontrolloni objektivat tuaja!

Sa herë mendoni për atë që duhet të arrini në jetë? Mund tju duket si lluks, por në fakt është shumë rezultate të gjeni kohë me bashkëshorten apo mikun tuaj të afërt, për të diskutuar çfarë do të donit në jetën tuaj. Mundohu ta analizosh jetën në të gjitha aspektet: materiale, shpirtërore, shoqërore dhe profesionale. Dil me ide konkrete për të gjitha ato gjëra që do të duhen vitin e ardhshëm, dhe jo për sot por edhe për 25 vjet. Kur përcakton qëllimin mos harro frazën SMART (Specific, Measurable, Attainable, Realistic, Timely) që do të thotë: Konkrete, e Matshme, e Realizueshme, Reale dhe e Kohës.

Hidhi në letër dhe tregojua edhe të tjerëve objektivat e tua!

Vite më parë kam lexuar një studim që pohonte se ata njerëz që hedhin në letër objektivat e tyre dhe ua kanë treguar edhe të tjerëve kanë qënë 33% më të sukseshëm nga ata që vetëm i kanë hedhur në letër. Parimi që

funksionon këtu është llogaridhënia. Duke i hedhur në letër dhe treguar edhe të tjerëve ju jeni bërë llogaridhënës jo vetëm tek vetja por edhe tek të tjerët.

Kontrollo procesin!

Një element tjetër i rëndësishëm i studimit që sapo përmenda, është ajo që pjesmarrësit në këtë studim informonin miqtë e tyre për çka kishin realizuar. Kjo bënte që ata jo vetëm të kontrollonin progresin e tyre por edhe të bëheshin llogaridhënës tek miqtë e tyre. Bëni një listë të objektivave ditore, javore, mujore, vjetore dhe të përjetshme dhe vari ato në një vend ku mund ti shihni çdo ditë vetë, me pjestarë të familjes apo edhe me miq të ngushtë. E bëni zakon të kontrolloni progresin tuaj, të raportoni periodikisht dhe të jeni sigurtë se do të bëni pjesë në ata 33% të sukseshmit.

Sikundër e dini, Dhjetori është muaji i fundit për tu kualifikuar për takimin Global Rally të vitit 2013 në Hawaii. Dhe kjo është e thjeshtë, mjafton të plotësoni për një vit 1500 CC, dhe ju do të keni fatin të provoni një program magjepsës trainimi, vlerësimi dhe argëtimi DHE mjaft kohë të lirë për të shijuar këta ishuj. Ka akoma kohë dhe unë e di se do t'ia arrini. Por për gjithë ata që për pak nuk e arrijnë këtë objektiv, unë ju them se dhjetori është pikërisht koha për të bërë planin për suksesin e vitit të ardhshëm. Gjenerali George S. Patton, i njohur për aftësitë e tij strategjike në Luftën e Dytë Botërore, ka thënë: Një plan i mirë për sot është më i mirë se një plan i përsosur për nesër.” Prandaj gjeni pak kohë në këtë fund viti për të hedhur në letër rrugën që do tju çojë në realizimin e endërrave tuaja dhe jam i sigurtë se do të arrini suksesin që dëshironi.


I JUAJ PËR JETË
REX MAUGHAN





Dhurata

Përsëri erdhi fundi i vitit, dhe përsëri për shumë e shumë njerëz dhuratat shndrohën në pyetje qëndrore . *Po çfarë të blej..., a do të kem para të mjaftueshme... dhe për kë duhet të blej, se mose harroj, sepse do të zemërohet, apo sepse edhe vjet mora dhuratë prej tij...* - shumë mendime të



ngjashme formulohen brenda nesh. Sigurisht, që të kemi mundësi për të blerë dhurata, kemi nevojë për një mjet teknik, të cilin sot në botë e quajmë para. Ndoshta në këtë periudhë ky mund të jetë edhe problem real, por nëse jemi njëherë antarë të Forever-it, atëherë e dimë edhe atë, që thjeshtë me rekomandimin e produkteve tona mund të arrijmë shumë shpejt tek ky mjet. Kjo do të thotë, që sa më shumë rekomandime të bëjmë, aq më shumë dhurata kemi mundësi të blejmë. N.q.s. e praktikojmë, dhe çdo ditë do ta praktikojmë këtë profesion, atëherë me një qetësi të plotë shpirtërore dhe materiale do të presim çastet para përgatitjes së dhuratave. *Po çfarë ti blej atij? Kujt do ti gëzohej më shumë?* Shpresoj, që nuk jam i vetmi mashkull mes shokëve me atë ,që më pëlqen shumë të bëj pazar. Ka mundësi që femrat e pëlqejnë këtë gjenetikisht – shpresoj, që me këtë nuk lëndoj asnjeri. Të bësh pazar është një ndjenjë e mrekullueshme. Më pëlqen edhe të bëj dhurata, këtë në rradhë të parë e pëlqejnë më shumë bashkëshortja dhe fëmijët e mi, dhe edhe për mua është një ndjenjë që më ngroh zemrën. Me pak fjalë kemi mbetur aty , që çfarë mund të blejmë? Mos shko në „dyqan” tjetër, nëse ke tëndin! Sigurisht të gjithë mendojnë me hollësi të gjitha vendet e dhuratave në qytet, ndërkohë që oferta më e mirë qëndron këtu në tavolinë, në tavolinën personale, në tavolinën e Forever-it:

TOUCH-I EKSKLUZIV I UDHËTIMEVE

Brenda tij ka produkte të mrekullueshme, dhe mund të përgatisim pako për secilin. Të vegjëlve dhe të mëdhenjëve në familje. Krahas produkteve mund të gjejmë brenda tij një kartë antarësie një vjeçare , me të cilën mund të udhëtojmë me çmime të ulta, dhe ka brenda disa lloje ofertash udhëtimi të tilla, që na drejtohen vetëm ne, të Foreverit, familjeve tona, fëmijëve tanë, gjithsej një zbritje me 150.000 Ft. Është një ofertë e pashoqe, apo jo? A të ka ofruar ty „kështu kot” kushdo 150.000 Ft, që: „hajde, merri, janë të tuat!”? Mua akoma jo. Prandaj edhe e shfrytëzoza këtë mundësi, dhe menjëherë bleva një touch ekskluziv. Tashmë edhe e kam menduar, që kush do të marri në familje udhëtimin, dhe atë, që edhe produktet të gjithë do ti pranojnë dhe do ti përdorin me kënaqësi. Bile, edhe kutinë e boshatisur të Touch-it mund ta përdor për prezantime të mëtejshme. Kjo do të thotë shfrytëzim 100% i produkteve! Deri tani nuk kemi patur dhuratë të tillë! Kjo është një surprizë madhështore për ne të gjithë. Oferta zgjat deri në 23 Dhjetor, dhe në qoftë se nuk e ke akoma dhuratën, atëherë mblidh shumë shpejt paratë për atë dhe blije! Mos vrapo nëpër qytet, nëse do të blesh libra dhe CD të mira, sepse edhe ato mund ti marrësh tek ne, janë sensacionale furçat e kozmetikës, apo qoftë edhe ditarët kalendarik! Dhe të mos harrojmë as dhuratat e paketuara për Krishtlindje! Përzgjedhjet janë shumë të mëdha, Supermarketi i Forever-it për Krishtlindjet funksionon. Mos mendo për gjëra të tjera, mendo për Forever-in, mendo për vetveten dhe mendo për të dashurit e tu! Në qoftë se ty biznesi të ecën në mënyrë të shkëlqyer, atëherë edhe ambjenti përreth do ta ndjejë veten shkëlqyeshëm.

Me këtë mendim të uroj festa të bekuara, Krishtlindje të qeta dhe një vit të ri të lumtur, të pasur në rezultate të shquara!

Përpara Forever!

DR. SÁNDOR MILESZ
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Holiday Rally

POREČ



Para shtatë vjetëve lindi një ëndërr: do të duhet një takim, që do të vërë në lëvizje rajonin, që do t'ju japë nxitje ndërtuesve më të talentuar të biznesit, jep mundësi takimi, dhe që është unik në botë. Ëndrra u realizua, e quajn: Holiday Rally.

Ditën e dytë të trajnimit të Poreçit prezantuesi **Tibor Lapicz**, soaring menaxher e formuloi mrekullisht, po përse jemi këtu: "Detyra juaj është, që nga këtu të çoni në shtëpi mesazhin, dhe në të ardhmen të vini këtu përsëri me dyfishin e këtyre njerëzve!" Tibor Lapicz me kolegën prezantuese, **Jadranka Kraljic-Pavletic** senior menaxher përshëndesin bashkarisht mysafirët, pastaj fton drejtorin për rajonin e Hungarisë **Dr. Sándor Milesz** mban një përshëndetje të paharruar, për ato momente, kur njeriu e ndjen me të vërtetë, që jeton - duke futur brenda gjithë energjitë e tij.

Radhën e merr **Péter Lenkey** - Menaxher i përgjithshëm, i cili flet për mundësin dhe zhvillimin në Forever: "Vendimin e pason veprimi, veprimin rezultati, i cili materializohet në jetët tuaja, kështu jeta e bazuar në besim do të bëhet e bazuar në vlera, ku çelësi do të jetë, puna e ndershme e njeriut. Nëse ju bazoheni këtu, nuk mund të jesh më i pambrojtur."



FLP-ja brenda katër vjetëve ka investuar 50 milion dallarë. Në Hollandë u ndërtua një magazinë që mbulon shtatëdhjetë vende, një fabrikë e re për prodhimin e tabletave në Shtetet e Bashkuara. "Qëllimi është, që të gjesh këtu atë që ke llogaritur, dhe të jesh krenar për atë, që punon në këtë firmë. Arri nga e mira deri tek e shkëlqyera, mjafton, që çdo ditë të bësh nga pak për atë. Bëje vetëm për veten tënde, jo për njeri tjetër" - shton general manager-i.

ZHVILLIM I BIZNESIT DHE I PERSONALITETIT

„Gjëja më e bukur në jetë, që mund të ndodhi me ju është Forever-i" - fillon leksionin e tij **Zlatko Jurovic** soaring manger nga Rijeka, i cili më parë ka qënë marinar, drejtues fabrike, si edhe sipërmarrës, por gjithmonë e ndjente, që priste për diçka. "U bashkova në firmën më të mirë në botë, pa ditur gjë për këtë". Rruga në përvojën me produktet, të mësuarit gradual i çoi deri aty, që Zlatko Jurovic dhe bashkëshortja të bëheshin menaxherë brenda dy vjetëve. Zlatko tregon për fate speciale: thotë, se cilët ndihmojë në arritjen e nivelit të menaxherit. Ai pretendon, se kjo mund të kopjohet nga kushdo. "Falë Forever-it u bëra njeri më i mirë, se sa isha, dhe tashmë e di: kjo ishte e koduar në politikën e biznesit. N.q.s. këtu nuk do të jeni të suksesshëm, ajo mund të ketë vetëm dy mundësi: ose nuk e keni vendosur, ose nuk keni punuar sa duhet. Ai që gjendet sot këtu, nuk mund të thotë më, që nuk ju dha mundësia."

Nga **Tünde Hajcsik** senior eagle menaxher mësojmë, se si mund të bëhemi pjesë e një grupi, në mënyrë të atillë, që të mos heqim dorë nga vetja, dhe përse një grup mund të jetë më i suksesshëm se shuma e antarëve të saj. Tünde me bashkëshortin drejtojnë biznesin më të fortë senior në Hungari. "Afiniteti, besnikëria, ishte tashmë i dukshëm që në rrugën tonë të parë në Amerikë, atëhere vendosa, që të gjitha sfidat ti realizojë. Për të tetën herë punojmë për Stimuluesin për Profit (nga tani: *Chairman's Bonus - red.*): firma na paguan ne nga viti në vit aq, sa të tjerët mbledhin gjatë gjithë jetës së tyre. Mjafton, që të punojmë me ritmin tonë, për këtë flet sfida e Eagle Menaxher-it. Këto janë mjetet më të mira për besnikërinë, për shprehjen e respektit ndaj kompanisë. Kur u bashkove, lidhe një kontratë me firmën: pranove planin e marketingut, por ke edhe të drejtat e tua - të dyja vetëm së bashku mund të jenë të vlefshme. Të kthyer me shpinë nga njeri-tjetri, por duke ecur përpara krah për krah."

Sipas pohimit të tij **Zsolt Leveleki** soaring menaxher u bë menaxher për distinktivin. Që nga ajo periudhë ndërton një nga bizneset më të forta të soaring menaxher-it. Kualifikimet në FLP kanë edhe pushtet. "Pushtet do të thotë, që ke forcë, mundësi, aftësi. N.q.s. e merr, mos e keqtrajto, më mirë ndaje midis atyre, që e meritojnë: nga kjo mund të jetë shumë. Kjo është një lojë reciproke - mëso të pranosh lavdërimet e njerëzve dhe ti kthesh ato përsëri."

Nëse dikush do të mbajë në mënyrë të përkryer rregulloren e biznesit, do ti arrijë nivelet, ashtu siç duhet, dhe atëhere do të zhvillohet në mënyrë të pashmangshme - beson Zsolt Leveleki. "Punon në një firmë të atillë, ku xhirua



Nga 1 janari i 2013-ës fillon periudha e re e kualifikimit për Holiday Rally. Bëhu aktiv, kalo në një nivel më të lartë! Takohemi në Opatij!

e të cilës është 75 milion forinta në orë, dhe drejtuesit e saj merren me atë, që të vendosin në xhepat e njerëzve para, mirëqënie, lumturi. Ji i denjë për këtë dhe bëje ashtu këtë biznes, që të mos jetë e mundur të kapen me ty - ji shembull! Për mua jeta ime është Forever-i, e adhuroj grupin tim. Mund të mbështeteni tek unë!"

VETËM NË FILLIM DUKET E VËSHITRË

Shumë ndërtues fillestarë të rrjetit ankohen, që e kanë të vështirë t'ju adresohen njerëzve të huaj. **Hajnalka Senk** safir menaxher-e nuk ka probleme të tilla. Ajo u takua me Forever-in në 2003-shin, prindërit u bënë menaxherët e 9 të saj. "Kryesore është vendosja e qëllimit, por n.q.s. nuk jeni në gjendje të zhvilloni kapitalin tuaj social, atëhere nuk do të mund të zhvilloheni, të mbushni dhomat, sallat, stadiumet" - thotë ajo. "Ky vlen më shumë se paraja - ky është kapitali yt i vetëm në këtë biznes. Nëse bëhesh simpatik për njerëzit, ata në mënyrë të pashmangëshme do të ti kthejnë mirësitë e vogla. Përdor të gjitha llojet e listës emërore, sepse flasin për mundësi biznesi që përhapet nëpërmjet fjalës. Edhe njohjet duhen praktikuar, duke mësuar metoda të tilla, me të cilat mund të influencojmë për të tjerët - edhe kjo mund të mësohet. Nëse i adresohem dikujt, shikoj atë, që me çfarë mund të kontribuoj në jetën e tij. Nuk ka sekret, mund të njihesh me këdo, kjo është një punë e thjeshtë dhe pambarim, e cila të forcon vazhdimisht në atë, që je në vendin e duhur."

Leksioni i **Róbert Varga** flet për motivimin e brendshëm. Menaxheri diamant-safir filloi biznesin në FLP në janar të 1998-ës. Ai thotë, se shkoi deri në fund të botës edhe për një njeri, nëse ai person me të vërtetë do diçka. "FLP-ja ka vërtetuar, produktet kanë vërtetuar, tani vjen ti" - thotë ai, pastaj flet për rregullat themelore të ndërtimit të biznesit. "Kushdo mund të sponzorizojë, por jo nëpërmjet kujdoje" - tërheq vëmendjen për mundësin e risponzorizimit - sigurisht krahas ruajtjes së rregullave të etikës. Të

tjerat janë më shumë pjesë e punës psikologjike: "ideve të tua mbizotëruese tërhiqun njerëzit dhe okazionet e duhura në jetën tënde. Kështu mendimet negative janë në kokë si lloje cd-sh negative. Po kështu forcë kanë edhe fjalët e thëna. Gjithmonë vëre theksin tek motivimi i brendshëm! Të mijat janë: shëndeti, mësimi, zhvillimi intelektual, harmoni në jetën bashkshortore dhe familjare, dhe për tu bërë shembull që ndiqet nga të tjerët." Nga Róbert Varga dëgjuam, se si mund ti vëmë në lëvizje njerëzit e bërë pasiv, ndërsa Tomislav Brumec tregon, se si është në gjendje ai të mbajë stabil rrethin e blerësve. Me bashkëshorten janë në Slloveni top distributorë, safir menaxher-ë. "Gjithmonë mund të jetë busull, nëse do të ndjekim shembullin e **Rex Maughan**-it, themeluesit të firmës. Në përmasa të vogla, duhet të hedhim ato lloj bazash, si ato që ai i formoi në periudhën e nisjes."

Sipas **Tomislav Brumecit** për këtë duhet të kalojmë në një zhvillim të vërtetë personaliteti. "Në parim të gjithë njerëzit janë të mirë, të dashur dhe të ndjeshëm: unë ndërtoj në bazë të këtij besimi. Lumturia nuk është rrethanë që qëndron jashtë nesh, por diçka, që lind nga brenda. Truri ka aftësi të ndikojë mbi çdo gjë, por tek kjo nga njëra anë duhet të forcojmë vlerat tona, nga ana tjetër duhet t'ju kushtojmë vëmendje vlerave të të tjerëve."



NUK KA TË PAMUNDUR

Menaxherja **Éva Váradi** e filloi biznesin në 2007-ën, dhe si studente fitonte qindra-mijra. Është e patundur, nëse është fjala për biznes: për atë angazhimi është i pari. Ashtu si insiston ajo tek kjo, po ashtu e pret këtë edhe nga bashkpunorët. Në shkëmbim gjithë antarët e grupit marrin po atë fuqi, njohuri, qëllimin e përbashkët. "Vetkënaqemi, shumë herë qëndrojmë më poshtë, se ajo që mund të merret prej nesh" - përballet ajo. Por n.q.s. nuk je aktiv, atëherë nuk je njeriu kyç. Nëse nuk bën, atë që të thotë sponsori, prej asaj dalin vetëm efekte negative. Ndjenja e fajit, keqardhja, vetë-justifikimi, shmangjet, kritika... është vështirë të jesh konsekuent, por është përgjegjësia jote, që cili je tani si dhe ajo, se si do të ndryshosh gjatë rrugës. Motivimi le të jetë forca jote e brendshme shtytëse!"

Që sa e rëndësishme është vendosmëria, lektorët e tjerë **dr. Renáta Szántó Szabóné dhe József Szabó** e formuluan me mençuri: "në punë nuk mund të lodhesh, vetëm në joefikasitet." Çifti ka katër vjet që ka filluar punën dhe brenda tre muajve u bënë menaxherë. Nuk ka nevojë të mendohet në gjëra të mëdha, "n.q.s. të thërrasin bashkpunorët, edhe ky është rezultat" - thonë, pastaj në mënyrën më praktike të mundshme, prezantojnë elementet bazë të ndërtimit të rrjetit. Marrim përgjigje për shumë gjëra: kur duhet bërë prezantimi familjar, me çfarë intesiteti, si ta organizojmë, si të zgjojme interesin, pastaj të fitojmë kohë... "Bëjeni, dhe rezultati do të vijë!" - na inkurajon çifti dhe pohon: "asnjë prej jush nuk është në kufirin e rendimentit njerëzor. Gjithmonë ka më shumë, gjithmonë ka më tej. Të gjithë jeni një vegël muzikore, akordi i të cilës atëherë tingëllon më bukur, kur tërhiqet. Filloni të punoni dhe luani muzikën më të bukur të jetës tuaj me mundësin e Forever-it."

Pas festimit të kualifikimeve të Holiday Rally-t, **Zsolt Fekete** flet për ftesën. Ai nga "rob lluksoz" u bë në atë kohë njeri i lirë. Prej tij marrim pothuaj një program të plotë, një vizion praktik, udhëzues që mund të ndiqet nga të gjithë. Një plan i mirë, motivim (nuk ka rëndësi, se çfarë, mjafton të jetë), orientim i të ardhmes, planifikim, objektiv i mirë, strategji e mirë: këto janë formulime kyçe. "Ishte, çfarë ishte, nga ky moment e rëndësishme është, çfarë do të jetë, dhe këtë ti do ta vendosësh - thotë Zsolt Fekete, pastaj flet për atë, se sa shumë gjëra bën një grup për tu bërë i pavarur dhe i veçantë - në fund të fundit: nga çfarë është grupi grup? Edhe këtu zgjidhja është objektiv i përbashkët. E gjithë kjo duhet për nisjen, por në punën e përditshme përtej objektivit duhet edhe qëndrueshmëri e mirë, sepse ftesa p.sh. është "punë sasiore" - paralajmëron Zsolt Fekete, ndërsa së fundi thekson diçka, të cilën ndoshta ai e njeh më mirë: forcën e buzëqeshjes.



SOLIDARITET RAJONAL

„Ndryshimet mund të fillojnë vetëm nga ne - pohon **Dragana Janovic** soaring menaxher-e, antare e President's Club të Forever-it të Serbisë. "Mbyllini sytë, imagjinoni gjithshka, që do të dëshironit, dhe filloni të punoni për të - këtu e bëni për veten tuaj, në vend tjetër për shefat tuaj. Përse të punosh për ëndrrat e dikujt tjetër? Sot mundësia më e mirë në botë është biznesi i FLP-s, sepse ky është i vetmi, i cili mund të fillohet pa kapital fillestar, ndërsa çeçet, që do të merni për punën tuaj, janë pa kufij. Le ti ndryshojmë gjërat rreth vetes tonë dhe t'ju a ofrojmë të gjithëve këtë mundësi! Dhe që ju tashmë e keni vendosur, e vërteton, që jeni këtu. Nga këtu vetëm duhet të kopjoni teknikën që



tashmë është vërtetuar shumë herë." Dragana Janovic na njeh edhe me dhjetë hapat bazë të MLM-s, që të drejton tek të qënit njeri kyç dhe në gjetjen e njerëzve të tjerë kyç.

Mustafic Safet senior menaxher është antar i President's Club të Forever Bosnjë-Hercegovinës. Tregon, përse duhet mbajtur aktivizimi edhe atëhere, nëse ndodhet në nivel të lartë. Me çfarë numër pikësh "duhet" të jemi të disponueshëm nga muaji në muaj, që të na trajtojnë si ekzemplarë. "Në Forever nuk ka punë të atillë, që nuk do të jetë e shpërblyer" - thotë Mustafic Safet, pastaj rreshton ato rregulla bazë, të cilat i zbaton edhe ai vetë. Në rradhë të parë disponon një objektivë të saktë, si edhe një plan, sepse - siç thotë - idetë nuk kanë asnjë vlerë, sa kohë që nuk fillojmë të punojmë për realizimin e tyre. "Nuk pres për atë, që rrethanat të jenë të përkryera, më mirë ju përshtatem atyre. Edhe vetes time i them gjithmonë: besoj në atë, që mund të jem i suksesshëm, dhe mund të ndryshoj jetët e njerëzve. Mos mendoni më pas, se cilat situata nuk i shfrytëzuar! Dita e sotme është më e mira për atë, që të filloni të punoni - mos prisni të nesërmen!"

Ágnes Krizsó safir menaxher-e është për trembëdhjet vjet një nga drejtueset më të suksesshme të rajonit hungarez. Për atë puna dhe familja janë të një rangu, koncepte që i shërbejnë njëra-tjetrës - ndoshta edhe nuk mund ti shpjegojmë ato pa njëra-tjetrën. Ágnes thotë: "shumë vetë e kanë lënduar, por vetëm fituesve ju lejohet të qajnë. Duhet të kesh kujdes, sepse çfarëdo që të bësh, tashmë me botën e Forever-it dole në dritë." Në sistemin e FLP-s bonusi me vlera rëndësishëm e bën atë unik, por edhe gjëra të tjera e bëjnë atë alternativën më të mirë: "nuk gjendet në asnjë vend tjetër, një sistem i tillë marrëdhëniesh, një qëndrim i tillë ndihmues ndaj njëri-tjetrit" - thotë Ágnes Krizsó. "Kthehu me guxim tek sponzori yt, sepse ka më shumë eksperiencë se ty, por po ashtu suksesi yt, është edhe interesi i tij. Dhe prandaj nuk ekziston ajo rrethanë, që di ti rezistojë një force të vendosur. Kërko njeriun e vërtetë!"

ATA QË NUK KANË NEVOJË PËR PREZANTIM

Çfarë është arrirë deri tani nga radhët e lektorëve, edhe ata që sapo e kanë filluar e kuptojnë: pra duhet planifikim i vetëdijshëm, por edhe intuitë për biznes, dhe kështu formojmë personalitetin tonë. Ashtu siç e formulon

Veronika Lomjanski - diamant menaxher-ja e parë e rajonit: "Suksesi yt është në dorën, mendjen, dhe zemrën tënde." Por nuk mund të jemi as të turpshëm, sepse puna në MLM flet pikërisht për para. Dhe që ku gjenden paratë në shekullin 21, e ilustron me një videofilm, sipas të cilit llogaritet që sektori i suksesshëm në të ardhmen do të jenë wellnesi (mirëqënia) dhe ruajtja e shëndetit. Që tani kanë një xhiro vjetore prej 200 miliard dollarësh, dhe kjo pritet të shumëfishohet në vitet e ardhshme. "Kjo është një mundësi e pa parë, ndërsa e ardhmja është e formave të reja të shitjes - thotë Veronika Lomjanski dhe shton se: "jemi përpara periudhës së mirëqënies. Disponojmë produkte të tilla, që janë më të mirat në botë. Por megjithatë rezultati vjen nga synimet më të thella. Unë vetëm prandaj pata sukses, sepse ndihmova njerëzit, që të jetojnë më mirë. "Veronika prej 44 vjetësh punon me njerëz, 24 vjet me MLM dhe 14 vjet me FLP-n. Paratë të fitohen nëpërmjet suksesit moral, shpirtëror dhe material, që ndërkohë t'ju japim edhe të tjerëve." Por nuk mund ti jepet kujtdo: "bashkpuntorët më të mirë janë



bashkpuntorë kërkues: kanë pyetje, por nuk ta vjedhin kohën kot. Unë i nis ata, që në kokën e tyre të krijohet një pamje e re: bëhet fjalë jo për kërkim parash, por për krijimin e tyre - dhe që këtu edhe veprojnë në interes të saj, ndërgjegjen e tyre e ushqen aspirata për sukses." Po afrohet fundi i dy ditëve të Poreçit - të paktën pjesa e saj zyrtare, sepse shpërblimi është akoma mbrapa: argëtimi dhe pushimi në hotelin me katër yje, të cilin në këtë periudhë e merr në posedim firma Forever. Por përpara çlodhjes rradhën e ka një leksion i shumëpritur: leksioni i **Miklós Berkicsit** diamant menaxher, i idhullit të shumë personave.

Ai thotë, që jemi pjesë e një momenti historik. Por - siç e formulon - pjesa më e rëndësishme e Poreçit është ajo, që vjen më pas. Ose e gjithë ajo, çfarë është thënë këtu është në gjendje të shfrytëzohet në praktikë nga supervizorët kur të kthehen në shtëpi. Poreçi ka aftësi të nisi dhe të rinisi njerëzit. "Poreçin e organizuan për jetën tënde, për familjen tënde, nëse erdhe për këtë, që jeta jote të ndryshojë." Njeriun në 80 përqind e bllokojnë frikëra, dyshime dhe pasiguri të tilla, subjekti i të cilës nuk do të ndodhi.

„Ji i mirë me veten, përndryshe nuk mund të sjellësh ndryshime në jetën e të tjerëve" - na këshillon Miklós Berkics. Ne, që e dëgjuam live leksionin magjepsës dhe argëtues të Miklósit për pushtimin e Bryce Canyonit me Zorron, e kuptuam mesazhin e ngjarjes: nga frika deri tek besimi është rrugë e shkelur, është rruga e fillestarëve në Forever.

„Ne të gjithë kemi jetuar ose jetojmë në skllavërin e frikave, por kush dëshiron të shkojë në shtëpi pa frika, të jetë i lirë, të jetë menaxher, të jetë diamant, të jetë i pasur?" - bërtet, dhe kur atij i përgjigjet i gjithë auditori i stadiumit, fillon një show mbresëlënës. Miklósi ju thërret të gjithëve, që të shkruajnë në një letër frikat e tyre, dhe t'ja japin atij. Arena filloi të mizëroi apo për gjatë dhjetë minutave mbledhi fletushkat në të gjithë sektorët. Dhe kur tashmë në skenë është mbledhur një grumbull i madh,

Miklós Berkicsi i ndez me flakë fletët e letrave në një enë metalike - jemi

dëshmitarë të një magjie të vërtetë, digjen në shoqërinë e duartrokitjes gjigande dhe të muzikës ngadhënjimtare, digjen, shndrohen në tym ashtu si frikët tona. E ardhmja është e "njerëzve të lirë" që qëndrojnë përreth skenës - shumë prej tyre në të ardhmen do të vijnë në Opatij si menaxherë, në Holiday Rally-n tjetër.

Me përshëndetjen e lamtumirës nga drejtori përgjithshëm

dr. Sándor Milesz dhe mikpritësi ynë, drejtori

rajonial i Kroacisë **dr. László Molnár**, si dhe me

parakalimin e lektorëve përfundon takimi i


madh i fundit i 2012-ës për rajonin, në 2013-

ën fillon një periudhë e re.



**DO TI SHIKOJE ME
KËNAQËSI TË GJITHA
FOTOGRAFITË E POREÇIT?
SHIKO FAQEN WWW.
FOREVERPHOTO.EU !
PËR TU FUTUR ËSHTË I
NEVOJSHËM FJALËKALIMI
QË DO TA GJESH EDHE
NË FAQEN TONË TË
FACEBOOKUT.**





Afron fundi i vitit, por në Forever akoma nuk ka ardhur koha e pushimeve, rrjetndërtuesit janë më shumë të angazhuar për fillimin e sulmit përfundimtar. Por ndërkohë ndaluan një moment të festojnë rezultatet e fundit dhe duan të sigurojnë edhe pak municioni profesional.

Success Day

BUDAPEST 17 NËNTOR 2012

Ferenc Tanács dhe Ferencné Tanács „në jetën civile” punojnë si mjek natyralistë, por në Forever ata tashmë kanë arritur nivelin senior menaxherë dhe nëpërmjet kësaj edhe organizator të Ditës së Suksesit të Budapestit. Gjashtë vjet më parë kanë filluar ndërtimin e biznesit vërtet mbi baza familjare: sponsori i tyre është vajza e tyre Erika Tanács. Pas demonstrimit të menaxherëve, së pari thirren „të rinjtë” dmth ata që marrin pjesë për herë të parë



në këtë takim trainimi por edhe vlerësimi të rezultateve të Forever Living Products. „Kjo ditë do tu ndryshojë jetën shumë njerzve. Këto 7 vjet na kanë dhënë më shumë se 50 vjet të marra së bashku. Së pari nuk guxonim të besonim, si edhe ju që nuk besoni tani, por që nga ajo ditë kemi shetitur botën. Gjithë këtë mund ta realizoni edhe ju!“

Pas fjalës të përshëndetjes, fjalën e merr drejtori i përgjithshëm **Dr Sándor Milez**. Si drejtues që arriti edhe nivelin e Zafir menaxherit, që nga viti 1997 ai qëndron me sukses në krye të këtij rajoni duke drejtuar 16 qendra, duke qënë edhe baba i 6 fëmijve. Në fillim përshëndet gjithë anëtarët e Klubit të Presidentit për punën e bërë prej tyre gjatë këtij viti, por ka sjellë edhe dhurata për publikun. Prej tij kemi mundur që Flota Forever Telefon të paraqitet me tarifa të reja më të favorshme. Pas kësaj prezanton kutinë Exkluziv Travel Touch, që ka 150 mijë forinta me skonto për raste udhëtimesh dhe që është pasuruar edhe me memorie flash e cila përmban materiale nga trainimi i Holiday Rally-it në Porecs. „Go Diamond, përpara për diamant, në sulm Forever!“ u drejtohet ai të gjithëve.

Rrjetndërtuesit gjithmonë interesohen shumë për leksionet e dhëna nga mjekët, mbasi kjo është një temë që mbështet bazat parimore.

Me ndihmën e **Dr. Mária Fábíán** – specialiste neurologe zhytmi në mes të neuroneve. Doktoresha përdor këto plotësues dietikë që nga viti 2000 dhe që nga 2004 është ekskluzivisht anëtare e familjes të produkteve të FLP. Për 6 muaj u bë menaxhere, që familjes ti jepte siguri. Zyrtarisht merret me ndërtimin, funksionimin dhe fenomenet e sistemit nervor. Në fillim nuk do ta besonim, por edhe në këtë fushë ka shumë rëndësi ushqyerja e duhur, me të cilën mund të parandalohen simptomat e difekteve. Lëngu cilësor i Aloes bën mirë si për dekontaminimin ashtu edhe për ushqyerjen. Por nuk ka funksionim të shëndetshëm të organizmit as pa vitaminat, probiotikët apo lëndët minerale cilësore, mbasi sistemi nervor qëndror që të drejtojë, vetëm atëhere mund të jetë në gjendje, kur edhe sistemi tretës, sistemi i lëvizjes si dhe sistemi i zemrës dhe i venave të jenë në gjendje të mirë. Duhet ta dimë cilat lëndë natyrore mund të ndihmojmë për këtë që nga hudhra, ganoderma, schizandra, kërpudha e deri tek ginko biloba. „Sistemi nervor vegjetativ mbron nga sfidat e përditshme, por në qoftë se nuk ushqehemi „digjen siguresat“ dhe shfaqen simptomat e sëmundjeve të trupit“ – tërhoqi vëmendjen Dr Mária Fábíán.

Mbasi supervisorët dhe asistent menaxherët marrin vlerësimin e tyre në skenë, vazhdojnë përsëri leksionet.

Edhe njëri nga djemtë e menaxherëve të Foreverit nga Zsombó, **István Csordás dhe Zsuzsanna Csordásné Tanács**, dhe më vogli do të donte të futej në këtë rrugë. „Duhet të mësojmë akoma shumë, por punojmë për të se na pëlqen tepër.“ Për ata ishte një motivim i rëndësishëm që në këtë sipërmarrje mund të punonin së bashku si familje. Siç thonë, kjo vetëm atëhere funksionon, në qoftë të gjithë „i përkushtohet asaj“. „Ka rëndësi që të mendojmë në mënyrë pozitive, dhe të kërkojmë njerëz të tillë me të cilët e ndiejmë veten mirë. Por esencial është edhe kopjimi: duhet ndjekur udhëzimet e sponsorve. Sigurisht të kopjojmë edhe diamantët...“ Çifti na tregon se cilësia e produkteve, CD, katalogët kanë qënë një ndihmë e madhe për ta.





BAMIRËSI

Komuniteti i distributorëve të Foreverit të Hungarisë dhe i vendeve të këtij rajoni në Holiday Rally grumbulloi një shumë parash, me ndihmën e të cilave Njësia e Evitimit të Katastrofave dhe Mbrojtjes Civile të Székely paisi me goma të reja dhe mundi të mbulonte shpenzimet e transportit të makinave ambulanca të marra dhuratë nga Gjermania. Shefi i njësisë, Géza Kolcsár, nëpërmjet një flete lavdërimi për këtë bamirësi falnderoi nismëtarët: Dr Milesz Sándor, József Szabó dhe Miklós Berkics.



„Këtë mund ta bëjë kushdo, nuk ka kufij moshe, apo diplome. Ne kemi patur një pagesë të mirë edhe më përpara, por nuk e dinim çfarë do të ndodhte, në qoftë se mbetemi mbrapa rrethit shoqëror, në qoftë se nuk mund të punojmë. Këtu funksionon edhe e drejta e autorit: kemi arritur aq sa edhe më vonë të jetojmë lirshëm. Nuk ka elementë pasigurie, sepse firma ka 35 vjet, ka siguruar një background; për gjendje malli nuk e vrasim mendjen, detyra jonë është të përcjellim më tej informacionin. Dhe e gjithë kjo krahas një lirie të pakufizuar! Ky është i vetmi ishull ku sundon uniteti, dhe është një gjë shumë e mirë të jetosh në këtë atmosferë.”

Senior menaxheri **József Heinbach** është anëtar i Foreverit që nga 2004, ai është inxhinjer kopshtarie, së bashku me bashkëshorten prej disa herësh janë anëtarë të Klubit të Conquistadorëve. Krahas sipërmarrjes të FLP, kanë edhe firmën e tyre private, jetojnë në Dunakeszi, bëjnë turne nëpër botë. Drejtuesi di gjithshka për bimët, natyrisht edhe për Aloen. Por lajmi i keq është ai, që toka nuk është më po ajo që ka qënë 30 vjet më parë. Varfërim, shpyllëzim, ndotje e tokës, prishje drastike e cilësisë të saj nga plehërat kimike. Se çdo të thotë saktësisht mungesa e lëndëve ushqyese për bimët, këtë e prekim nga eksperimentet dhe fotot e bëra prej tij. Dihet që struktura kimike e klorofilit është e ngjashme me atë të hemoglobinës, për rrjedhim edhe për bimët ka po aq rëndësi magneziumi sa edhe hekuri për njeriun. Por edhe për atë, se nga se përbëhet „mëngjezi i kampionëve”, se si e shijojnë pijen e Aloes dhe pse nuk lejohet të hiqet dorë nga ky mall silësor.



Demostrojnë ata me mbi 60 cc+, të kualifikuarit e Klubit të Conquistadorëve, si dhe menaxherët e rinj dhe shpallen edhe të kualifikuarit e rinj të programit stimulues të autoveturës. **Zoltán Tóth**, si personi që ka zënë vendin e parë në Klubin e Conquistadorëve, na flet disa fjalë: „Ky është rezultat i të dy neve, mbasi kjo është një lojë në skuadër, linja jonë e sipërme janë gjenialë; ke kë të ndjekësh. Këtu ka rezultate të larta, dhe rruga është e hapur për këdo që nuk e braktis – ky është sekreti. Unë e kam vendosur të punoj me firmën më të mirë, me produktet më të mira.

„Në qoftë se dikush e di se që kur ndodhet këtu, ai e di se herët me të do të vijë mrekullia, na besoni, që kjo do të thotë diçka” – thotë menaxherja e sapo kualifikuar **Anna Franyó**, por mikrofonin e marrin edhe disa të tjerë.

Ildikó Dinya: „vetëm nuk do të kisha mundur ta bëja, esenciale është ta dini, pse e bëni, pastaj është çështje kohe kur do të jeni këtu lart në podium.”

Dr. Lászlóné Kozó dhe Dr. László Kozó: „Shumë vetë kemi patur dhe kemi pas nesh si mbështetje, ju faleminderit të gjithëve!”

András Hollósy: „Ky është rezultat i shtatëdhjet ditëve punë, ju lutem një duartrokitje për skuadrën!”

Janë të shumtë ata që kanë si dhuratë një mënyrë jetese natyrale, qetësi, pak pushim dhe zhvillim personaliteti: duke pritur fëmijën e ardhshëm. Por këtë nuk e kishte senior menaxherja **Edina Hanyecz**, kur letrat e mjekut thoshin: për shkak të një operacioni të mëparshëm nuk mund të lindte fëmi. Kjo ia ndryshoi jetën, shumë vrau mendjen për gjendjen e organizmit të saj dhe për të më në fund krejt papritur mbeti me barrë. Në moshën 40 vjeçe solli në dritë fëmijën e saj pas një barre pa ankesa. Tash jep këshilla para atyre që duan fëmijë: çfarë mënyrë jetese dhe çfarë mënyre ushqyerje i ndihmon ato në këtë periudhë. Ajo shpjegon në mënyrë të hollësishme dietën se si pikërisht zhvillohen sistemi i kockave, sistemi nervor dhe kyçet e foshnjës në barkun e nënës. Vjet në maj Edina ka lindur Áron-in, por ajo as në periudhën e lehonisë nuk e la kujdesin e duhur për ushqyerjen e shëndetshme. Kur i lindi djali, edhe ai e pëlqente xhelin e Aloes – dhe këtë na i tregon me foto. Edina na tregon se si mund të vazhdosh ndërtimin e rrjetit krahas raportit të lindjes. Ajo na pohon se shëndeti dhe dashuria janë me paqen shpirtërore.

Lektoren pasuese e thërrasin në skenë si zonjën e vendosur dhe të vetëdijshme për objektivat e saj, dhe të cilën duhet imituar. Motoja e saj është: bën me të tjerët ato që do të doje të bënin edhe të tjerët me ty. Soaring menaxherja **Terézia Herman** është partizane e ecjes përpara hap e nga një hap me punë të përbashkët. „Me një bashkpunëtor të ri, së pari duhet të kërkojmë psetë e vërteta: objektivat, për të cilat është i prirur ta bëjë. Si ndihmë kemi librat, materialet trainuese dhe të fiksojmë datat e rëndësishme dhe sfidat që lidhen me to. Por pjesa e luanit të punës i takon rrjetndëtuës, sigurisht i lidhur me linjën e sipërme, me linjën e poshtme, por edhe me firmën. Unë kërkoj 50% punë, dëshirë për sukses, durim, qëndrim pozitiv. Dhe



Veni kuriozë nga
çfarë udhëhigjen
menaxherët e rinj?
Shfletoni
faqen 30!



sigurisht edhe unë dëgjoj çfarë kërkon pala tjetër prej meje” Terézia Herman leksionit të saj i hedh edhe pak garniturë: si përgatitja e listave, ftesa e njerzve, prezantimet familjare dhe teknika e regjistrimit. Dëgjojmë definicione për zgjerimin e rrjetit, ndërtimin në front të gjërë dhe në thellësi si dhe çfarë përvoje duhet të kesh me produktet. Sipas Terézia Herman, të tjerat janë vetëm çështje e ligjit të numurave. „Pa objektiv kurrë mos fillo me askënd, ec përpara në bazë të përshkrimit në programin Start dhe pastaj lufto me vështirësitë e tua duke thënë: do ta garantoj suksesin!”

Pas përshëndetjes të asistent supervisorëve të sapo kualifikuar në podium ngjitet menaxheri diamant-zafir dhe lektori i shkëlqyer **Róbert Varga**. Për atë motivimi i fillimit ishte që të shlyej borxhet, pastaj të mund të ndihmonte sa më shumë bashkpunëtorë për arritjen e objektivave. I pëlqejnë sfidat , ka ngjitur Malin e Bardhë (Monte Blanc) dhe majën Kilimanxharo, baba i dy fëmijve. Teza e parë: merr vendimet në bazë të ndjenjave të njerzve. Për ilustrim të kësaj, ai prezanton bashkpunëtorin e tij **Attila Huszai**, i cili natregon pse një sipërmarrës zgjedh biznesine FLP. Duket se atë e ka bindur forca e personalitetit – sepse këtu letra e fitores është komunikimi njerëzor. „Në qoftë se ke gjetur njeriun e duhur, atëhere ke siguruar një të ardhur si e drejtë autori prej 6%, dhe që këtej nis orteku; në qoftë se edhe ai gjen vetëm 5 vetë dhe ata nga 5 vetë, nuk ka më ndalesë” – na shpjegon Róbert Varga.





Na prezanton disa nga drejtuesit, që megjithse në front kanë nga një menaxher të tyre, në thellësi është ndërtuar një perandori gjigante, e cila gjatë 10 vjetëve i ka siguruar të ardhura qindmilionsh. „Midis shumë përgjigjeve „jo“ gjithmonë ka edhe „po“. Mëso, praktikohu, bëje me gjallëri, bëj të paktën 5 prezantime në javë! Objektivi caktuar i takon të shkuarës, sasia e pikëve të tanishme dhe vizioni të ardhmes. Vetëm mos harro: çdo vit në Hungari lindin më shumë se 95 mijë fëmij, duke hapur tregje të reja të fuqishme. Përveç atyre, këta që janë: nuk ka njeri që nuk do të kishte nevojë për këto produkte.“ Këto janë logjike, por Róbert e di edhe atë, se çfarë duhet për suksesin: „raporti i efektit pozitiv me atë negativ, sa i frymëzuar je. Mendimet që mbizotërojnë në jetën tënde të tërheqin në veprimet e duhura. Të kërkojmë njerëz të tillë, që kanë qëllime në jetë, që kërkojnë mjetet dhe janë të prirur për ti realizuar këto qëllime. Produkti ynë i vërtetë është shëndeti dhe mirëqenia materiale; në këtë rajon kurrë nuk ka patur kaq nevojë për biznesin e FLP sa tani.“

25 pikët e mia

Çfarë ka pas pikëve? Kuptim jete, stabilitet, krahë mbrojtës, familje të lumtur, dashuri. Një mjet me të cilin mund të arrij qëllimet e mia. Modeli për mua: linja ime e sipërme, sponsori András Hollósy. Çdo njeri ka dëshirë për vlerësim, dhe ky rast sot më është dhënë! A ka lumturi më të madhe se kjo?

**Tünde Barkócziné Gasperek
Supervizore**





11 VJETORI I KRIJIMIT TË FLP TË SLLOVENISË


Salla e takimeve në Qendrën e Kongreseve ishte zbukuruar si për festë. Nëshkëlqimin e dritës të shandaneve shndriste shqiponja e vendosur mbi xham akulli, duke përshëndetur ngjitjen në skenë të menaxherëve, ndërmjet tyre **Dragana dhe Miloš Janović** - soaring menaxherë, të **Dr Sándor Milesz**, si dhe të **Andreja dhe Tomislav Brumec** – zafir menaxherë, po kështu të diamant menaxherëve **Stevan Lomjanski**.

Drejtes të programit ishin **Jožica dhe Miran Arbeiter** - senior menaxherë dhe anëtarë të Klubit të presidentit të cilët përshëndetën pjesmarrësit, pastaj në skenë u thirr drejtori rajonal i FLP të Sllovenisë.

Dr. Sándor Milesz – drejtor i përgjithshëm lavdëroi në mënyrë të veçantë Slloveninë, sepse nga pikpamja e xhiros tash prej disa vitesh vjen e dyta në rajonin tonë, mbas Hungarisë. Në shënjë mirënjohje për punën e përkushtuar solli si dhuratë paketën Exkluziv Travel Touch , në të cilën ndërmjet të tjerash gjendet edhe një kartë udhëtimi. Me këtë mund të realizohen udhëtime të mrekullueshme, që për anëtarët e klubit ka një skonto të veçantë, dhe për destinacione të veçanta në periudhën para krishtlindjeve, dmth deri më 23 Dhjetor 2012 ato mund të vizitohen edhe me një skonto 150 000 Ft. E veçanta e e kësaj skontoje, se atë mund tua dhurojmë edhe të dashurve tanë. Drejtori i përgjithshëm premtoi se krahas kësaj pakete gjatë festave do të kemi edhe ulje të tjera.

HA BIRT





Menaxherja **Danica Bigec** – na prezantoi me pamje dhe me fjalë rrezikun e mosmbajtjes si duhet të trupit dhe pasojat e rënda që rrjedhin nga kjo. Na tregoi se si mund të mbrohemi ndaj këtyre problemeve, dhe se si mund ti lehtësojmë ngërçet dhe dhimbjet.

Këngtarja e mrekullueshme **Saša Lendero**, na këndoi e shoqëruar me mandolinë, zeri i saj mbushi sallën dhe të tjerët u përfshinë në valle.

Dr. Miran Arbeiter - senior menaxher dhe anëtar i Klubit të Presidentit gjithmonë na flet për rezultatet më të reja. Tani na prezantoi dy nga produktet e shkëlqyera, që u rekomandohen në radhë të parë grave dhe burrave në moshë të pjekur. Vitolize Women dhe Vitolize Man janë përgatitur sipas studimeve shkencore më të fundit dhe janë ideale për moshat e mëdha.

Gjatë vitit 2012 pati një numur distributorësh të sukseshëm, të cilët u kualifikuan dhe u bënë fitues të çmimeve dhe shpërblimeve të udhëtimit. Njëzëri pohojnë se me edhe më pak energji më tepër mund të ngjiteshin edhe më lart.





Ruga deri në nivelin e menaxherit është e drejtë dhe e shpejtë, vetë duhet kujdesur për të ndjekur këshillat e sponsorit, na thekson si sekret të suksesit menaxheri **Roman Očišnik**. Ai që nuk i kushton vemendjen e duhur, dhe nuk merr vrull mund të mbetet për pak nën majën e suksesit. pikërisht në atë moment duhet të marrim hov që të arrijmë nivelin e menaxherit.

Tomislav Brumec distributori kryesor i Sllovenisë, zafir menaxher dhe anëtar i Klubit të Presidentit na flet për përvojën disa vjeçare, se si mund të të tërheqim distributorë të rinj në këtë biznes. . Kemi produkte të shkëlqyera të FLP, një plan marketingu brilliant, prandaj në radhë të parë duhet përqëndruar në mardhëniet me njerzit, që të mund të ndihmojmë sa më shumë të tjerët. Njerzit e ndiejnë sinqeritetin dhe kjo gjithmonë shumfishohet.

Stevan Lomjanski – diamant menaxher dhe anëtar i Klubit të Presidentit, na flet me llogarira konkrete, sa para mund të humbasin çdo vit ata që kanë harruar se edhe për pagesën duhet bërë diçka. Befasuese të dhënat e xhiros vjetore, që na Stevan, por nuk duhet të harrojmë rregullin 1+3, të qënies aktiv, në qoftë se besojmë se kemi arritur çdo objektiv, sepse ky është minimumi që Rex ka caktuar, që kurrë të mos flemë në dafina.

Në qoftë si dikujt do ti kishte vakur vemendja, **Saša Lendero** në shoqërimin e **Mišo Kontrec** u kujdesën që të rigjallërohemi përsëri.





Asistent supervisorët janë e ardhmja e biznesit tonë. Ndërkohë që në sfond gjëmon muzika, **Dr Sándor Miliesz** u dorëzon atyre distiktivin e shqiponjës, që është simbol i plotësimi të kushteve dhe që shkalla e parë e biznesit Forever tashmë për ta është arritur.

Veronika Lomjanski diamant menaxhere dhe anëtare e Klubit të Presidentit na vjen çdo vit në Ditën e Suksesit të ditlindjes të FLP Sllloveni dhe si dhuratë na shërben me informacione të dobishme për një punë më të sukseshme. Na tërheq vëmendjen që çështje të parëndësishme të mos na shpërqëndrojnë vëmendjen. Gjithmonë të përqëndrohemi tek ata bashkpunëtorë, që janë të prirur të na ndjekin dhe që e dëshirojnë suksesin. Leksionin e saj frymëzues e mbyll me atë, që nuk mund ta dijë se çfarë do të donim ne, por di atë që ajo dhe Stevani duan të arrij gjithnjë e më lart, prandaj dhe janë të prirur ta bëjnë, dhe nuk u ka shkuar ndërmend të dalin në pension.

Ishte një kënaqsi e vecantë për ne që në takim morën pjesë edhe miq nga vende e tjera të rajonit, ndërmjet të tjerëve anëtarë të Klubit të Presidentit nga rajoni ynë, Drejtori përgjithshëm Dr Sándor Miliesz dhe drejtori rajonal i FLP të Serbisë **Branislav Rajić**. Sukseset tuaja janë edhe sukseset tona! Faleminderit për punën tuaj të palodhur dhe për besimin e palëkundur.


Gjithë të mirat, FLP të Slllovenisë!

Takohenmi përsëri në Ditën e Suksesit të ardhshëm më 23 mars 2013!



lifestyle

Këshilla për mënyrën e jetesës



LËVIZJA ËSHTË JETË

Çfarë na thotë fizioterapisti?

Lidhja e ngushtë midis gjimnastikës dhe shëndetit tashmë është e njohur prej shekujsh. Por rëndësia e saj nuk ka qënë kurrë kaq e rëndësishme sa në kohën e sotme që kërcënohet nga obeziteti, për shkak të mjeteve të shumta të transportit dhe plot me sfida për shëndetin. Çdo mbrëmje duke medituar për ditët tona e ndjejmë sa të cflitur jemi, por kjo jo për shkak të një lëvizje trupore të qëllimshme!

Rol të madh ka familja për ta bërë të dashur gjimnastikën sepse shembulli që merr në familje është përcaktues gjatë gjithë jetës. Ka shumë rëndësi interesimi dhe tërheqja e prindërve pas sportit. Në qoftë se fëmija rritet në një familje të tillë ku prindërit marrin pjesë aktive në çdo veprimtari aktive,

ku shalojnë biçikletën në vend që të rehatohen në makinë, atëhere kjo bëhet një gjë e natyrshme. Ai fëmijë që mësohet me shëmbullin e mjedisit familjar me lëvizje të qëllimshme, atëhere ashtu si edhe të rriturit do të kërkojë mundësinë për plotësimin e kërkesave për lëvizje.

Dihet se edhe foshnja në barkun e nënës, bën lëvizje aktive, qoftë edhe në mënyrë instiktive. Aktivitetin e filluar që në mitër duhet ta mësojmë e zhillojmë më tej pas lindjes. Gjimnastika e bebes pas lindjes ka një efekt të shkëlqyer trupor dhe shpirtëror si për gjëndjen e nënës ashtu edhe të bebit sepse përbën baza të mira për zhvillimin e lëvizjeve të foshnjës. Fëmijët e vegjël qoftë edhe në mënyrë natyrale kryejnë aktivitet të lartë fizik (duke qënë në lëvizshëm të vazhdueshme nga mëngjezi deri në darkë, por më vonë duhet synuar me vetëdije që gjimnastike sistematike të bëjet element i qënies së tyre. Në qoftë se prindi, që nga lindja i jep fëmijës hapësirën e duhur për gjimnastikë të kënaqshme, qoftë



edhe në kuadrin e programevet ë përbashkëta familjare, atëhere ky do të jetë shembulli që ai do të ndjekë.

Në qoftë se fëmijët në kopësht dhe më vonë në shkollë arrijnë një instikt pozitiv për lëvizjet fizike apo lojrat e shumanshme, atëhere kjo nuk është një detyrë e pazgjidhshme dhe nuk do të ndjejë sforcim dhe detyrim , por e kundërta. Pa u vënë re tek të gjithë ne rrënjoset loja, shkathtësia, loja e futbollit, lojrat me skuadër, kërcimi vetmohues që jep forcë dhe të mban gjallë. Gjimnastika dhe sporti tek të rriturit , pengon plakjen dhe pakëson rrezikun e sëmundjeve. Koha dhe energjia kushtuar kalitjes sonë fizike, në perspektivë të afërt kompenson përmirësimin e cilësisë të jetës sonë dhe në tërësi të konservon dhe të mban të ri!

Ngarkesa e programuar si duhet nuk forcon vetëm muskujt e lëvizjeve por përmirëson edhe shkallën e efektit të funksionimit të mushkërive dhe të zemrës, qarkullimin e gjakut dhe metabolizmin. Oksigjeni dhe lëndët ushqyese mbrijnë më shpejt në qeliza, ndërsa bioksidi karbonit dhe lëndët që janë përdorur nga indet dalin më shpejt në qarkullimin e gjakut dhe arrijnë tek organet dekontaminuese. Si rezultat i kësaj rritet gjithashtu rezistenca dhe niveli i energjisë. përmirësohet efekti i shkëmbimit të gazrave në mushkëri (nxjerrja e bioksidit të karbonit dhe thithja e oksigjenit) dhe rritet aftësia e përcjelljes të oksigjenit në gjak. Edhe në muskuj mbrrin më shumë oksigjen, dhe kështu atom und të funksionojnë për një kohë të gjatë pa dhimbje. Ndërsa në efektin e stërvitjes do të jenë të afta për më shumë punë dhe detyrat mund ti përballojnë më lehtë.

Zemra jonë do të rrahë më fortë, në qoftë se e mësojmë me stërvitje sistematike dhe për rrjedhim do të pompojë më shumë gjak në qarkullim. Muskujt e zemrës përballojnë më shumë ngarkesë, mund të nxjerrin më shumë gjakë gjatë çdo tkurrje, prandaj edhe pas disa javëve gjimnastike sistematike vëmë re ndryshime për mirë në rrahjet e pulsit. Stërvitja fizike përmirëson lëvizshmërinë e kyçeve dhe forcon kokcat. Efekti i muskujve të ushtruar mbi kokcat ndihmon marrjen e kalciumit nga kokcat dhe parandalimin e ostoporeozës. Lane dhe bashkpunëtorët e tij, në vitin 1986 kanë kontrolluar atletët e moshës mbi 50 vjeç. Tek 41 sportistë, kanë gjetur 40% më shumë përmbajtje lëndësh minerale krahasuar me rezultatet

kontrollit të një grupi të kësaj moshe që nuk është marrë me sport.

Me lëvizje fizike sistematike mund të prevenohen më lehtë edhe kapsllëku, përmirësohet tretja, largimi i helmeve nga organizmi si dhe funksionimi i imunitetit. Mund të paraprihet dhe të mbahet në ekuilibër diabeti i moshës të pleqërisë, mund të ulet tensioni i lartë, dhe sasia e indeve të tepërt dhjamore. Nën efektin e lëvizjeve fizike sistematike përmirësohet niveli i kolisterinit dhe brënda tij niveli i kolisterinit „të keq”, dmth niveli i kolisterinit LDL, dhe njëkohësisht rritet në gjak raporti i kolisterinit të „mirë” HDL që ka efekt mbrojtës. Zgjerohen arteriet dhe pakësohen mundësitë e krijimit të trombeve në to.

Shoqata amerikane e luftës kundër sëmundjes Alzheimer në konferencën ndërkombtare të organizuar në Vancouver disa javë më parë: studjuesit e Universitetit Brit-Columbia dhe të

Universitetit Illinois kanë shpallur rezultatet e eksperimentit me 86 gra të moshës 70 vjeç. Tek gratë e përfshira në këtë studim ishin shfaqur shënjat e para të dobësisit të kujtesës. Pjesmarrëset u ndanë në 3 grupe; pjestaret e njërit grup bënë shetitje në këmbë 2 herë në javë, grupi tjetër ngrinte pesha ndërsa grupi i tertë bënte ushtrime në ekuilibër. Pas 6 muajsh pjestareve të grupit që ngrinte pesha treguesit e memories ju përmirësuan shumë më tepër se 2 grupeve të tjera. Ndërsa në mesin e

atyre që bënin lëvizje në këmbë ishte më i përmirësuar në krahasim me 2 grupet e tjera raporti i mbajtjes të ekuilibrit, lëvizshmërisë dhe kapaciteti i sistemit të venave të zemrës.

Shoqata Amerikane e Kancerit thekson se rastet e vdekjes nga kanceri do të ishin më të shmagshme me një mënyrë jetese të shëndetshme. Arma më efektive e parandalimit është kalitja fizike e trupit. Ato gra që janë stërvitur rreth 2 orë e gjysëm në javë, kanë 34% më rrallë rrezikun e kancerit të mitrës në krahasim me ato që janë më pak aktive – thekson grupi studimor i universitetit Yale. Ata theksojnë gjithashtu se në rastin e peshës trupore normale rreziku është pakësuar 73% në raport me ato që bëjnë jetë inaktive dhe mbipeshë.

